

NË BERN TË ZVICRËS U PROMOVUA “LIBRI I PAQES“



LIBRI I PAQËS

U DEDIKOHËT BREZAVË TË ARDHËSHËM

Behide Hasanaj

14. Mai ·

NË BERN TË ZVICRËS U PROMOVUA “LIBRI I PAQES”

Pas një pune të gjatë e me përkushtim, realizova botimin e “Librit të paqes”, i dyti me radhë, më datë: 11.05.2019 në Bern të Zvicrës ia dola ta bëj promovimin, me një organizim të mirë dhe përkrahje të njerëzve të kulturës, artit, të diplomacisë dhe qytetarë të shumtë, që kishin ardhur nga qytete të Zvicrës dhe nga Kosova, që s’bashku e begatuan këtë festë të librit.

Kështu, përveç të pranishmëve tjerë, qytetarë e dashamirë të librit, bashkëveprimtarë, miq e shoqëri, në këtë promovim ishin të pranishëm edhe personalitete të diplomacisë, kulturës dhe arsimit, ndër të cilët: Ambasadori i Republikës së Kosovës në Zvicër, Islam Spahiu, Konzulli i Gjenevës, Ramadan Avdiu, Prifti Andreas Nufer, Prof. dr. Vaxhid Sejdiu, Kryetarja e Shoqatës Mbretëresha Teuta- Shenida Bilalli, Udhëheqesi i Këshillit të prindërve dhe arsimtarëve të shkollës shqipe në Bern, Riza Demaj, Kryetarja e Klubit letrar “Latif Berisha” nga Vushtrria, Ermira R. Jusufi, Mësuesja nga Gjilani, Flora Rashiti, me referimet e saj për përmbajtjen e librit, përfaqësuesja e shkollës shqipe nga Ostermundigeni – Bern, Ida Jashari, etj.

Përveç fjalimeve përshëndetëse të pjesëmarrësve dhe vlerësimeve për librin, me një fjalë rasti u paraqit edhe Ermira R. Jusufi, e cila përcolli përshëndetjet e krijuesve të Klubit letrar nga Vushtrria, duke vlerësuar lartë bashkëpunimin e tyre me autoren, në përkrahjen në forma të ndryshme për realizimin e librit. Këtë manifestim kulturor e bëri edhe më madhështor prezantimi i Ansambllit folklorik autokton “Rugova” nga Peja, i prirë nga Vesel Nikçi, solistët dhe valltarët e të cilit interpretuan shumë këngë e valle me motive nga Kosova. Ky ansambël kishte ardhur enkas për këtë organizim dhe meriton çdo lëvdatë për punën që ka bërë, që kjo ditë të ketë vërtetë pamje festive. Recitali kushtuar për femrat më të arritura gjatë etapave nga aktori Fadil Grabovci dhe Recitali për Nënë Terezën nga fëmijët e shkollës shqipe nga Ostermundigeni – Bern, të udhëhequr nga Ida Jashari, ishin dy nga realizimet e bukura dhe tema të qëlluara. Poashtu, zëri i magjishëm i sopranos Elona Mathieu, në shoqërim të pianistes Ermira Lefort ishin mrekullia tjetër e këtij organizimi kaq dinjitoz dhe të paharrueshëm për mysafirët, që na nderuan me prezencën dhe kontributin e tyre në këtë ditë të veçantë, jo vetëm për pjesëmarrësit, por edhe për gjithë komunitetin shqiptar, këtu. Edhe televizionet: “Fol Shqip” nga Zvicra, “TV Fontana” dhe “TV Istogu” ishin kontribuesit e fuqishëm të këtij manifestimi, që bënë të shpërndahet informacioni për këtë promovim gjithandej kah jetojnë e veprojnë bashkëatdhetarët tanë, që ishin edhe kontribues në shumë raste emergjente gjatë periudhës së luftës në Kosovë.

Nuk mund të shpreh me fjalë atë që meritojnë këta pjesëmarrës, bashkëveprimtarë dhe kontribues të shumtë që libri të ketë vendin merititor dhe ky manifestim të kurorëzohet me kaq sukses.

Nga zemra i falënderoj të gjithë një për një, për shpirtëbardhësinë që treguan këtë ditë, nga më të veçantat për mua, duke i uruar që gjithmonë të kenë suksese në jetë dhe aktivitetet e tyre!

Behide Hasanaj

Përzemërsisht









**I RESPEKTUARI TË
RESPEKTON
11. MAJI E
NJËRZËVE
TË PAQES NË
BOTË**

**GJYSMA E PUNËS
ËSHTË
E KRYER KUR FILLON
ME VULLNET**



Behide Hasanaj

*Während der Balkankrise äusserte sich die
Barmherzigkeit der Schweiz in Form materieller und
moralischer Hilfe, die sie meinem von vielen Leiden*

*geplagten Volk in Kosova in dessen schwierigsten
Tagen zukommen liess.*

*Mein Dank an die Schweizer/Innen und der Schweiz ist
ein Dank, der von tiefstem Herzen kommt – und dies
nicht nur von mir als Mitwirkende, sondern auch von
allen Bedürftigen, die Hilfe bekamen.*

*Seit 1983 lebe ich in der Schweiz und engagiere mich in
wohltätigen Projekten. Dabei unterstützten mich
Schweizer und Schweizerinnen und trugen dazu bei,
Menschen zu helfen, die infolge der Balkankrise in
Armut und Not geraten sind.*

*Mit vollem Recht kann deshalb gesagt werden:
Barmherzigkeit ist eine Eigenschaft, die in der Seele des
Menschen wurzelt. Sie verlangt einen starken Willen
und den Wunsch, dort zu wirken, wo es möglich und
notwendig ist. Sie leistet einen Beitrag zum Frieden, wo
immer ihre Früchte die Bedürftigen erreichen
Als Dienerin der Barmherzigkeit haben mich alle so
akzeptiert, wie ich bin; besonders die Schweizerinnen
und Schweizer. Hierfür danke ich dem Schweizer Volk
und der Schweiz von ganzem Herzen.*

***Die Schweiz ist die Nummer 1 in Sachen
Barmherzigkeit***



Behide Hasanaj

Gjatë krizës në Ballkan, zemërgjerësia zvicerane u shfaq në formë materiale dhe ndihmë morale, të cilën populli im i shumëvuajtur në Kosovë e mori në ditët më të vështira të tij. Falënderimi im për zviceranet/ët dhe për Zvicrën është një falënderim, i cili vjen nga thellësia e zemrës – dhe jo vetëm nga zemra ime si bashkëveprimtare, por edhe prej të gjithë njerëzve në nevojë, të cilët kanë marrë ndihmë.

Që nga 1983 unë jetoj në Zvicër dhe angazhohem në projekte bamirëse. Me këtë rast mua më kanë përkrahur zviceranët dhe zviceranet dhe kanë kontribuar, që t'ju jepet ndihmë njerëzve, të cilët si pasojë e krizës në Ballkan kanë përfunduar në varfëri apo në nevojë.

Kështu që me të drejtë të plotë mund të thuhet: Dhembshuria është një veti, e cila rrënjët e saj i ka në shpirtin e njeriut. Ajo kërkon një bindje të fortë dhe dëshirën për të qenë aty aktiv, ku është e mundshme dhe e nevojshme. Ajo e jep një kontribut për paqen, ku frytet e saj gjithnjë i arrijnë ata që kanë nevojë...

Si shërbyese e dhembshurisë, të gjithë më kanë pranuar kështu siç jam unë, në veçanti zviceranet dhe zviceranët. Për këtë e falënderoj popullin zviceran dhe Zvicrën nga zemra.

Zvicra është numër 1 sa i përket dhembshurisë.

Përmbajtja e filmit dokumentarë kushtuar bamirësisë dhe humanistes shqiptare BEHIDE HASANAJ. Titulli - NË UDHËN E SHËNJETORËS." Dokumentari është ndërtuar mbi te vërtetë jetësore të personazhit kryesor. Në këtë rast të zonjës BEHIDE HASANAJ. Skenari letrar e artisik përshkon në mënyre të detajuar jetën dhe kontributin e saj Si humaniste, bamirëse që në moshë të re dhe deri ditët e sotme. Rrjedha kronologjike e jetës dhe veprimtarisë humanitare mbështet e pasqyrohet nëpërmjet shumë fakteve e ngjarjeve nëpërmjet imazheve e komenteve nga skenari dhe sinkroneve të peronazheve të ndryshem të cilët kanë bashkëpunuar me Behiden. Stuktura bazike përmban; 1- vendlindja, famija e kontributi për qëshijen kombëtare. 2- Fëmijeria, shkollimi, peripecite e saj në ndërtimin e jetës. 3- Siperfaqja e bulzave të para që në moshë të re te humanizmit. 4- Largimi nga vendlindja arsyet përse mori rrugën e kurbetit 5 - Fillimet e jetës së vështirë në kurbet për përballimin e jetës Integrimi dhe përshtatja me jetën dhe rregullat e një shteti si Zvicera e njohur botërisht si vendi, me human, më njerëzor e më kontribus për jetën e mbijetesën e tyre., 6- Bashkepunimi me struktura shtetërore e shoqata të ndryshme humanitare, 7- Puna, mundi dhe përkushtimi për të ndihmuar popullin e saj ne përballimin e dhimbjeve, plagëve të shkaktuara nga regjimi më barbar serb. Boshti që përshkruan kurbën e dokumentarit është Behide Hasanaj humaniste bamirëse nënë e mire shoqe e kolege e nderuar. Gjithë jetën e saj e sakrifikoi për njeriun e vuajtur e me halle për KOSOVËN. Për nënat e vajzat e dhunuara barbarisht Për realizimin e dokumentarit idës e përcjelljes së mesazheve janë realizuar xhirime në PËJË, GJAKOVË, GJILAN, CYRIH, BERN dhe VENDE TE TJERA. intervistime bashkëpunor e kolegë të saj zvicerane nga Kosova njerëz të thjesht që jane ndihmuar e përkrahur nga BEHIDE HASANAJ. Gjithashtu një ndihmë të madhe në imazhimin sa ma korrekt e më vërtetësi është arkivi që na vuri në dispozicion Z.Hasanaj

U shfrytëzuan shtypi që ka pasqyruar dhe komentuar për veprimtarinë humanitare e bamirëse te zonjës Behide Hasanaj. Ndjem i nderuar dhe privilegjuar që jam realizues i një dokumentari për njeri i cili i kushtoi jetën bamirësisë Njerëz të tillë i duhen sot njerzimit, jam i lumturuar se humanizmi e përkushtimi i saj vazhdon, shikim të këndshëm shihemi në realizimin e serisë së dytë flm per cfare keni bërë për Kosovë popullin shqiptarë zoti ju ndihmoftë

Me respekte e konsiderate, Regjisori dhe skenaristi LLESH NIKOLLA.

LIBRI I PAQËS

U DEDIKOHËT BREZAVË TË

ARDHËSHËM



Faleminderit,

Të gjithë atyre të cilët më ndihmuan në rrugën time të humanizmit dhe solidariteti kombëtar dhe ndërkombëtar, sepse vetëm një dorë e shtrirë drejt atyre që kanë nevojë në momentet më të vështira dëshmon shpirtin e njeriu të lirë. Faleminderit Shoqatave Humanitare dhe institucioneve të ndryshme ne Zvicër, të cilat gjithmonë u gjenden të gatshme të ndihmojnë popullin shqiptar në Kosovë dhe më gjerë.

Faleminderit donatorëve, bashkëpunëtorëve, njerëzve të paqes, të cilët në momentet më kritike ndaluan masakrën e shekullit me emrin Republika“Kosovë”. Ata, të cilët penguan gjenocidin sllav mbi shqiptarët më 1980.1996.1997. 1998. 1999

do të jetojnë përgjithmonë në zemre time dhe në zemrat e shqiptarëve.



Libri i paqës

Për të studiuar

Përmbajtja e monografisë së dytë mund të mendohet edhe si libri i paqes shfrytëzohët dhe bamirësisë, ku mendoj se i nevojitet çdo institucioni si p.sh. shkollave, studentëve në universitet, arkivave, shoqatave, organizatave humanitare dhe universiteteve të shkencave politike dhe historike, të të gjitha niveleve e shkollave të ulta dhe ato të larta, të cilave duhet ti kushtohet vëmendje dhe shpjegim i mjaftueshëm nga përgjegjësit se si mund të vie deri te shkatërrimi i një shteti moralisht, gjeografikisht etj. Duhet t'u tregohet për vrasjet e popullatës, për vuajtjet, për familjet e mbetura pa strehë, për vuajtjet e popullit tonë që vite me radhë kaluan nëpër këtë tmerr.

Duhet të mundohemi që sa më e shumë dhe ashtu siç e kemi me traditë nga paraardhësit tanë ta duam njëri tjetrin të mos ketë konflikte në popullatë, të mendojmë ndërtimin e shtetit tonë dhe t'u ndihmojmë të varfërve. Këto duhet t'i trashëgojmë dhe ti bartim gjeneratë pas gjenerate të vazhdojnë edhe pasardhësit tanë në mënyrë të njëjtë.

Një popull do ishte më i fortë kur të gjithë do flitnin një gjuhë dhe do kishin të njëjtin mendim për shtetin e tyre, andaj duhet të jetë mësim për rinin tonë të ardhshme dashuria e atdheut dhe ndërtimi i saj, primar në jetën e tyre.



Përkthimi prej momentit kur është fjala për zonjën Behide, dhe si është krijuar kontakti me organizatën për popujt e kërcënuar Theo Vom Fellenberg

Rexhisorin Llesh Nikolla parashtron pytjet për Znj.Behide Hasanaj ku pergjigjet Theo Vom Fellenberg (Anëtare I NATOS)

(MVI_7945)

Si e keni krijuar kontaktin me zonjën Hasanaj, kur ka qenë kontakti i parë?

Nuk me kujtohet saktë kontakti i parë, por më kujtohet se ka qenë dikur në vitet e 80, kur ne e kemi par se gjendja në Kosovë është shumë e vështirë për popullin shqiptar. Për ne si shoqatë/organizatë për popujt e kërcënuar, ka qenë për detyrë ta mbështetim Kosovën. Kanë jetuar shumë shqiptar në Zvicër, ata kanë organizuar në sallën “Mapa Mundo” mbledhje kur në fund të viteve te 80 kanë treguar filma dhe e kanë demonstruar situatën në Kosovë. Zonja Behide, dikur në vitet 80 është bërë anëtare e organizatës sonë për popujt e kërcënuar. Jemi organizatë private. Behidejaka ardhur tek ne dhe ka thënë „Ne duhet të bëjmë diçka, situata në Kosovë është shumë e keqe dhe jo humane”

(MVI_7953)

Faleminderit për komplimentet për Zvicër. Nuk jam sigurt a ka bërë Zvicra me shumë se shtetet tjera për Kosovën. Diferenca me shtetet tjera ka qenë se në Zvicër kanë punuar shumë shqiptar në vitet 70/80. Për Zvicëranët populli shqiptar ka qenë popull i njohur, dhe janë krenuar për kontaktet me Shqiptarët në atë kohë. Kjo ka qenë mbas luftërave ballkanike. Për njerëz jashtë Ballkanit nuk ka qenë e qartë ku po ndodhin këto luftëra, kërcënime rreth Ballkanit. Mbas këtyre luftërave kur situata në Kosovë vazhdonte të ishte e rëndë dhe jo humane, dhe Zvicra filloi të regjistroi shumë refugjat dhe filloj ti sensibilizoi për ta kuptuar situatën më shumë. Me këto parakushte si ashtu dhe puna gjuhës gjermane dhe shqipe se e ka ditur Behidja ka qenë e mundshme për Behiden të bëjë punë shumë të mira në temën humanitare. Behideja ka qenë në mes të Zvicrës dhe Kosovës, ka pasur kontakte dhe ka kërkuar kontakte.

(MVI_7955)

Pyetja: Si ka qenë zonja Behide në gjendje me e arritur këtë punë shumë të mirë me kushtet dhe situatën e jetës saj?

Këtë pyetje edhe ne ja kemi bërë vetes. Behidja ka qenë shumë prezentë (pranishëm), ka komunikuar shumë mirë me shumë zvicëran. Është një njeri shumë komunikativ. Ka krijuar diçka, dhe ne nuk e dim siq e ka bërë këtë punë, se Behidja ka punuar si motër dhe i ka rritur dy fëmijë është angazhuar shumë dhe ka krijuar shumë.

(MVI_7957)

Më duket se mundem të them se Behidja konfliktit në Kosovë ja ka dhënë një fytyrë humane. Zvicëranët që kanë qenë gati ta mbështetin Kosovën ju ka nevojitur dikush që e njohin, që mundën të flasin me të. Ka qenë mes se shumti personi që i motivon njerëzit. Kjo është një forcë shumë e madhe.

(MVI_7960)

Unë besoj kur një rast si në Kosovë, që nuk është i ri por është e mprehte, filluan mediat të tregonin, dhe refugjatët të vinin. Kjo krijon ndjenjën të njerëzit tu ndihmojnë këtyre refugjatëve. Në këtë moment është shumë me rëndësi që vjen dikush si Behideja dhe e simbolizon këtë dhe rast krijon një rrugënjë mundësi të ndihmës. Me këtë hapen shumë mundësi. Behideja ka qenë e besueshme, njerëzore. Si organizatë Behideja ka qenë e vogël vetëm një person. Don të thotë me këtë u ka hekur frigën njerëzve se paratë që i dhurojnë korruptohen. Si

ndihmues në këtë rast e kanë ditur se munden ti besojnë Behides. Në organizatat e mëdha humanitare është në pyetje më shumë tek kontrolli. Njerëzit kanë dëshirë ti kontrollojnë parat që i dhurojnë. Ta dine ku shkojnë parat. Kjo është mekanizëm i ndryshëm. Kur një krizë si në Kosovë është kaq e mprehtë. Kjo bazohet në besim dhe këto Behidja e ka pasur një rol shumë të veçantë. Formimi i besimit.

Mbas luftës, do të thotë mbas 1999 janë krenuar shumë organizata të ndryshme humanitare që kanë mbështetur Kosovën krenar. Këto organizata kanë udhëhequr me shumë projekte të rindërtimit.

Unë besoj se në çdo katastrofë humanitare preken njerëz në zemër dhe kanë dëshirë të ndihmojnë. Ka shumë mënyra të ndryshme si dhe mundësi të mbështetësh këta njerëz të vuajtur. Shumica e njerëzve japin para në një organizatë humanitare të madhe dhe e përfundojnë këtë temë me kaq. Po në rastin e Kosovës ka qenë situata e veçantë, sepse ne kemi pasur kontakte direkte me shqiptarët përmes Behides.

(MVI_7962)

Njerëz të kishës kanë pasur dëshirë të ndihmojnë, por nuk kanë ditur si të ndihmojnë. Në këtë moment vinte Behideja, përfaqësuesja e këtyre njerëzve, që zviceranët kishin dëshirë ti mbështesnin. Behideja organizoi një transport dhe u tregoi njerëzve që kishin nevojë për medikament ushqim dhe sende tjera. Kështu është krijuar ndihma e madhe. Behideja ka qenë siguria garancia se si këto ndihma të arrijnë në Kosovë, te njerëzit që u nevojiten.

Unë besoj se ka pasur shumë organizata të ndryshme që ka ndihmuar kjo është pjesa më bukur e ndihmës humanitare.

Njerëzit bashkohen dhe janë të motivuar të ndihmojnë.

Edhe një fjalë për organizatën për popujt e kërcënuar.

Detyra jonë nuk është të ndihmojmë, por më shumë ta informojmë popullin zviceran për luftërat, ngjarjet në këto vende po ashtu edhe për Kosovën sepse mediat janë plot me propaganda. Në radhë të parë organizata jonë do të informojmë korrekt, në radhë të dytë mundem të bëjmë aksione ndihmuese. Po ne nuk jemi "Fort" në këtë, për këtë arsye ka qenë shumë me rëndësi për Behiden ti ketë këto kontakte. Behideja ka informue, ka motive dhe I ka mobilizua njerëzit.



Pjesa e Dytë e Librit të Znj. Behide

Fjala e Prof. Dr. Adem Zejnullahu për Autorën

Vepër me rëndësi dokumentare

Veprat autobiografike në literaturën shqipe, por edhe në literaturat e popujve të tjerë, nuk janë të shumta. Nuk do mend, se secili autor ka dëshirë që të bëmat e veta jetësore t'i shkruajë, t'i botojë duke i konsideruar si akt-veprim të rëndësishme në radhë të parë për veten, por edhe për të tjerët. Këta autorë, vazhdimisht në vetëdije e kanë frikën se mos po bien nën ndikimin e emocioneve – subjektivizmit, ndaj zakonisht ua lënë të tjerëve që t'ua shkruajnë. Mendoj, se është mirë që këto monografi të shkruhen edhe për të gjallë të subjekteve, për shumë arsye, në radhë të parë se këta autorë e dinë më së miri veprimtarinë, kontributin e tyre se çka kanë bërë, si e kanë bërë, sukseset dhe mossukseset, në mënyrë që në vazhdim të punës e të jetës t'i plotësojë zbrazëtitë e hetuara në mënyrë që kur vepra ta marrë trajtën e botimit, të jetë në përputhje me synimet dhe me kërshërinë e lexuesit në një kohë e në një hapësirë të caktuar.

Në radhën e këtyre njerëzve bën pjesë edhe Behide Hasanaj, e cila shquhet për një veprimtari të pasur jetësore e humanitare. Ajo tërë jetën dhe veprimtarinë e saj, për disa dekada, ia kushtoi popullit të saj dhe më në fund arriti që ta shkruante dhe veprën e dytë **Libri i Paqes**. Titulli i veprës në rrafshin simbolik - nënkupton lirinë, paqen, dashurinë ndërnerëzore, për të cilën edhe autorja e donte dhe punonte, ndaj veprimtarinë e saj humanitare ua kushtoi nevojtarëve, të cilët ndihmën e saj e konsideronin si shpëtim jete,

në momentet më të vështira jetësore, kur u mungonin edhe gjërat më elementare për ekzistencë.

Që në fillim duhet thënë se vepra **Libri i Paqes**, e Behide Hasanajt, ndonëse në rastet më shpeshta është shkruar në vetën e parë, ajo kontributin e saj ua adreson edhe institucioneve shtetërore të Zvicrës, shoqatave humanitare, sidomos “Nënë Terezës”, me nëndegët: në Thur dhe Lucern, xhamive dhe imamëve të ndryshëm, pastaj figurave të shquara publike, individëve vullnet mirë, të cilët në qenien e tyre kishin altruizmin dhe donin për t’i ndihmuar nevojtarët që vuanin për shkaqe të agresionit serb.

Poetët, filozofët thonë se jeta ka shumë ngjyra. Dakord. Po jeta i përngjan trëndafilin me gjemba që erëmon, ther, e dhemb. Jeta për shqiptarët gjatë historisë nuk ishte nënë e mirë, ajo ishte njerë, ndaj më tepër u dhuroi vuajtje, sakrificë, qëndresë, robëri, luftë, tragjedi e krenari sesa liri paqe, dashuri e prosperitet. Në këto rrethana të ndërlikuara, **bamirësia – altruizmi** i njeriut për njeriun, ishte ma se i nevojshëm që t’i kundërvihet mizantropizmit, thënëse njohur - se njeriu për njeriun është ujë, e cila fatkeqësisht u dëshmuar shumë herë gjatë historisë, tek shumë popuj të botës, por edhe tek shqiptarët, ku shekuj me radhë serbët në mënyrë institucionale bënë krime nga më të ndryshmet.

Filozofia jetësore ka dëshmuar se njëra ndër vlerat më të rëndësishme të njeriut është respekti dhe kultivimi i marrëdhënieve të mira ndërnjerëzore midis racave, popujve dhe feve të ndryshme. Ky virtyt, akt sublim meriton të vlerësohet, të ruhet dhe të bartet ndër breza, sepse ta shpëtosh jetën e njeriut është akt, virtyt njerëzor, human, trimëri, burrëri dhe madhështi e heroizëm, por ta marrësh është ligësi, krim që tërë jetën të ndjekë pas si hije – fantazmë.

Vepra autobiografike e Behide Hasanajt përbëhet kryesisht nga dokumentet e shkruara, veçmas nga fotot dhe dokumentet e tjera të cilat dëshmojnë për punën e saj në rrafshin humanitar, dedikuar nevojtarëve dhe skamnorëve të cilët përballëshin me jetë a vdekjet. Libri nuk ka karakter shkencor. Kompozicioni i saj përbëhet nga dokumentet e ndryshme arkivore, fotot që dëshmojnë dhe zërojnë fuqishëm dimensionin informativ e kuptimor për realitetin jetësor e historike të popullit tonë gjatë viteve 1997 - 1999.

Historia e popujve të ndryshëm të botës, por edhe e kombit tonë dëshmon se në kohë të vështira, dalin figura të shquara, të cilat me veprimtarinë e tyre u dalin në ndihmë të tjerëve. Kështu, kanë arritur të bëhen të pavdekshëm, siç është Nënë Tereza, e njohur në botë me shumë të tjerë. Edhe Behide Hasanaj e ndoqi rrugën e saj, duke dhënë gjithçka nga vetja për të tjerët.

Vepra autobiografike dokumentare: **Libri i Paqes** e Behide Hasanajt ka strukturë autobiografike, informative e arkivore që gjithsesi ka një rëndësi të veçantë, sepse ngërthen në vete shumë të dhëna, dokumente, dëshmi, foto dhe shkrime të tjera të ndryshme të cilat dëshmojnë fuqishëm për një periudhe të caktuar jetësore e historike nëpër të cilën kaloi populli ynë dhe Kosova gjatë luftës së fundit të viteve 1997-1999.

Behide Hasanaj, veprën e vet: **Librin e Paqes**, e ka sistemuar në pesë kaptina të veçanta, të cilat kanë lidhje njëra me tjetrën, sepse trajtojnë çështje e probleme të njëjta që kanë të bëjnë me Kosovën dhe popullin e saj, në raport me forcat ushtarake serbe dhe me faktorin e jashtëm ndërkombëtar, në krye me Amerikën dhe me disa shtete të fuqishme të Evropës, të cilat në momentet më vendimtare të kombit tonë, i dolën në ndihmë, duke përkrahur në aspektin diplomatik e ushtarak për çlirimin dhe pavarësimin e saj. Pra, secila nga këto kaptina të këtij libri korrespondojnë ndërmjet vete me fije të dukshme e të padukshme, sepse tema bosht është e njëjtë: **zhvillimi i ngjarjeve më të rëndësishme në Kosovë në harkun kohor 1998-1999.**

Demonstratat e popullit tonë në vitin 1981, të cilat vazhduan pandërprerë deri në fund të luftës në Kosovë të vitit 1999, kishin kërkesën për barazi të shqiptarëve me popujt e tjerë të ish-Jugosllavisë. Këto kërkesa, për fat të keq, nuk hasën në mirëkuptim të organeve kompetente shtetërore federative të asaj kohe, por përkundrazi rinia dhe populli i Kosovës u gjakos në vazhdimësi nga forcat ushtarake serbo-sllave.

Me kalimin e kohës gjendja në Kosovë gjithnjë e më tepër keqësohej në të gjitha aspektet, e sidomos në atë financiar dhe të sigurisë. Shqiptarët nuk ndiheshim më të sigurt për asnjë moment, ata akuzoheheshin për të gjitha të këqijat që ndodhnin në hapësirat e këtij shteti. Ishin fajtorë kujdestarë për gjithçka që ndodhte e s'i pëlqente shtetit serb, ndaj sipas politikës serbomadhe, ky popull duhej ndëshkuar, përjashtuar masovikisht nga puna, rrahur, djegur, plaçkitur, vrarë qytetarë e ushtarë, helmuar fëmijë e nxënës nëpër shkolla, madje edhe në mënyrë institucionale, me qëllim të caktuar që të nënshtroheshin dhe të asimiloheshin.

Kosova dhe populli i saj gradualisht në vitet '90 u bë njëri ndër problemet më të ndërlikuara për qarqet evropiane e botërore politike, diplomatike dhe ushtarake, sepse gjendja gjithnjë vinte duke u shkallëzuar, sa mund të merrte përmasa të një rreziku të madh ballkanik dhe më gjerë, ndaj Amerika me disa shtete të fuqishme të Evropës, vendosën që ta ndëshkojnë Serbinë, duke e bombarduar për disa muaj.

Në këto rrethana të ndërlikuara për popullin tonë, sensibilizimi i çështjes së Kosovës në diasporë kishte një rëndësi të veçantë, sepse ajo kishte mundësi më të mëdha për të njoftuar opinionin evropian e botëror; se çka po ngjet me Kosovën dhe popullin e saj përballë krimeve serbe. Diaspora bëri shumë në atë periudhë: informoi, propagandoi, protestoi, transmetoi foto të ndryshme nga krimet serbe mbi shqiptarët, shkroi peticione e lutje për ndërhyrje ushtarake të NATO-s në Kosovë. Diaspora e ndihmoi Kosovën dhe popullin e saj edhe në aspektin financiar dhe ushtarak.

Shumëçka që ka ndodhur në Kosovë dhe rreth saj, është përfshirë në veprën monografike të Behide Hasanajt, e cila pa dyshim ka dhënë një kontribut të rëndësishëm humanitar, duke grumbulluar dhe shpërndarë ndihma të shumta për Kosovën dhe popullin e saj. Ajo, duke bashkëpunuar dhe vepruar me figura të shquara publike zvicerane për të Drejtat e Njeriut, dhe më gjerë, informoi opinionin evropian dhe botëror për të gjitha reпреzaljet që i bënin forcat ushtarake serbe mbi popullin e Kosovës. Por, do thënë se Behidja, rolin kryesor e ka pasur në angazhimin humanitar, të cilin e ka kryer me sukses, duke sjellë shumë ndihmat të larmishme në Kosovë, në Shqipëri, në Ulqin dhe në vende të tjera ku ndodheshin refugjatët shqiptarë, ajo ka ndihmuar edhe në forma të tjera. Kjo humaniste e palodhur, ndihmat e dërguara nëpër vende të ndryshme, i arsyetonte dhe i dokumentonte mirë me dokumentacion të nevojshëm, duke sjellë dëshmi, fatura, foto dhe shkrime të tjera të nevojshme, të cilat e dëshmonin punën e saj korrekte në raport me dhënësin - marrësin dhe shpërndarësin.

Kjo humaniste e shquar, një kontribut të veçantë ndaj nevojtarëve e ka dhënë edhe nga të ardhurat e veta personale, duke e shitur shtëpinë në Pejë, dhe të gjitha të hollat, sipas saj, ua ka shpërndarë të gjithë atyre që kanë kërkuar ndihmë.

Si dimension i veçantë në këtë vepër autobiografike të Behide Hasanajt paraqitet edhe dhunimi i femrave shqiptare nga forcat ushtarake dhe paraushtarake serbe, para dhe gjatë luftës në Kosovë, që është njëri ndër problemet më të rënda individuale dhe kombëtare, sepse ende edhe sot e kësaj dite, viktimat vuajnë nga ankthi i kriminelëve serbë, duke kërkuar drejtësi e ndëshkim, që fatkeqësisht ende nuk u realizua.

Forcat ushtarake serbe, krahas rrahjeve, plaçkitjes, djegieve, vrasjeve pa dallim moshe dhe gjinie, përdorën edhe dhunën seksuale ndaj grave e vajzave shqiptare, me qëllim të caktuar, si strategji ushtarake me anën e të cilës synonin që sa më shumë ta tmerrojnë popullatën shqiptare, ta demoralizojnë që t'i braktisin vatrat e tyre etnike. Këtë strategji të pushtuesve e pohon edhe Organizata Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (Amnesty International), kur thotë se - kështu ka ndodhur tërë kohën gjatë historisë.

Behide Hasanaj në veprën e saj **Libri i Paqes**, e ka pasur për bazë parimin e njohur: **më mirë është një shembull konkret** – foto, dëshmi, shkrime, botim në media të ndryshme, apo diç tjetër, në trajtë dokumentacioni, sesa **një mijë fjalë të zjarrita** për një çështje a problem të caktuar. Ajo kështu veprroi, solli një numër të madh fotosh të ndryshme, dëshmish, mirënjohjesh, përkushtimesh, të cilat flasin me gjuhën e fakteve për punën dhe angazhimin e saj humanitar në Kosovë dhe më gjerë.

Në fund duhet thënë se vepra: **Libri i Paqes**, e Behide Hasanajt, ka përmbajtje dokumentare, që ngërthen në vete aktivitetin e saj, por edhe të institucioneve shtetërore zvicerane, shoqatave bamirëse, individëve dhe të gjithë atyre vullnetmirëve që u angazhuan për ta ndihmuar Kosovën dhe popullin e saj, në kohët më të vështira, ndaj botimi i librit ka rëndësi të veçantë edhe në aspektin dokumentar për kompletimin e dokumentacionit arkivor për shumë ngjarje të rëndësishme, të cilat u zhvilluan në Kosovë, për luftën e UÇK-së, gjatë periudhës 1998- 1999, të cilat mund t'i shfrytëzojnë historianët, sociologët dhe të tjerët për shkrime të kësaj natyre.

Prishtinë, tetor 2018

NJË JETË VEPRIMTARIE HUMANITARE PËR POPULLIN LIRIDASHËS E BEHIDE HASANAJT

Pas gati katër dekadave pune intensive në veprimtarinë humanitare, ka kohë që është biseduar e po bisedohet që të bëhet një punë e tillë – të shkruhet një libër për një grua e cila tërë jetën ka bërë diçka për të gjithë njerëzit që kanë pasur nevojë për te, në të gjitha rrugët e jetës, por më shumë kur kishin nevojë për një kashore buk, për një kokër krip e për një gotë ujë e për një trohë çlodhje e gjumë të rehatshem. Ka bërë diçka për vendlindjen e saj, e shumë më shumë ka bërë diçka për Kosovën dhe popullin shqiptarë, të përndjekur e nëpërflakje lufte, e cila asnjëherë nuk ka arritur të bëhet e plotë, sipas dashurisë së sajë për të, dhe asnjëherë nuk arrinte të merrte frymë lirshëm ashtu siq donte ajo, qoftë edhe për të ardhur deri të miku dikun në qytet. Ka bërë diçka për ata që janë përballur me dhunën shtetërore hegjemoniste serbe në vitet tetëdhjeta kur helmoheshin nxënësit e të gjitha shkollave në Kosovë vetëm pse ishin shqipëtar. Ka bërë diçka për gjithë ata që i kanë trokitur në zyrat e organizatave humanitare botërore e në veçanti në Zvicër, me të cilët ka bashkëpunuar dhe nga të cilët është përkrahur, për popullatën e përndjekur nga shtëpit e tyre nga të gjitha fshatrat dhe vendbanimet në Kosovë. Ka bërë diçka për të gjithë atë popullat në flakën e luftës në Bosnje Kroazi Kosov Shqipri Maqedoni mbar Njerzimin Botper gjitha nazijolitetet për të u dalur në ndihmë të përnjekurve, të plagosurve dhe atyre që u mungonte kafshata e gojës. Ka bërë diçka edhe për trimat e lirisë, të cilet nuk pynin për asnjë pushtet, për asnjë ushtri, për asnjë grup paramilitarësh serbo-

çetnik, por bënin luftë të drejtë çlirimtare për tokën e Kosovës, që ta bëjnë të lirë, sovrane e demokratike. Ushtria Çlirimtare e Kosovës për këtë grua, që zëri i ka shkar në katër anët e botës për punë të palodhshme e vetmohuese humanitare, është ajo që e soli lirin për një popull që asgjë nuk kursej me breza për të qenë i lirë.

Kjo zonjë për të cilën është bërë kjo monografi dhe e cila tërë jetën ia ka kushtuar veprimtarisë humanitare për ta ndihmuar në radhë të parë popullatën e përndjekur nga barbaria serbosllave rrugëve të botës nga trojet e veta tremijëvjecare, ata të cilët kishin mbetur në nevojë në Kosovë si edhe ato vajza e gra që ishin nepërkambur e përdhunuar nga ushtria e forcat paramilitare të Serbisë.

Kjo grua që lindi në Pejë bjeshkët e Rugovës dhe e rriti shtatin nën freskin e këtyre bjeshkëve, në Pejë, ku u rrit dhe u edukua ka bërë shumë n'përballje me varfërinë dhe kujdesin e fëmijve e të prindrve, ka bërë shumë deri në migrimin e sajë në Zvicër dhe fillimin me punë në organizatat humanitare në Zvicër e në Sarajevë në kuader të Organizatës humanitare "Nëna Terezë".

Kjo Zonjë që quhet BEHIDE HASANAJ, me angazhimet e sajë në Zvicër, ka bërë shumë në mbledhjen e ndihmave për Kosovën. Apelet e sajë ndaj bashkatdhetarëve, në punën si përkthyes vullnetare, në vizitat e rrefugjatëve në kamplet e diasporës bartja dhe shpërndarja e ndihmave në Kosovë në zanat e luftes si edhe në kampet e rrefugjatëve në Shqipëri e Maqedoni, ndaj të varfërve e familjeve me jetim, në ndihmën e madhe dhe kontributin ndaj UÇK-së,. Ka bërë me punën dhe aktivitetin e vet edhe në sensibilizimin e çështjes së Kosovës me dhenjen e deklaratave në mediat e gazetat botërore e shumë çështje që do të zbardhën në këtë monografi.

Kjo zonjë, për të cilën po bëhet kjo monografi, kabërë diçka edhe për familjarët e vet, për djalin dhe vajzën që i donë dhe i përkrahë, por që edhe ata e dojnë dhe e përkrahin në punën e aktivitetit humanitar gjithandej botës kudo që ka punuar e vepruar e kapasur këtë përkrahje e cila e a nxitur për punë. Tërë jetën është përpjekur që prindrve që nuk i ka në jetë, po edhe fëmijve, nipave e mbesave t'ua ruante identitetin nga ata që nëpërkëmbnin. Ka bërë diçka për familjen e gjerë, edhe për faretisin dhe Pejën që aq shumë e don, jo vetëm për të iu krijuar kushte dhe mundësi që të jetonin më mirë, jo vetëm që të shkolloheshin e të bëheshin të jotëvarur, por edhe i mësonte që të ecnin drejtë në jetë e të bëheshin me vlerë për atdhun dhe kombin shqiptarë.

Prandaj, kur para 5-6 muajsh, një miku im, mergimtarë në Suedi me shkruante së do të jam në kontakt me një zonjë që ka bërë shumë për Kosovën do e kërkonte ndihmën time për shkruarjen e një libër për këtë grua, unë nuk njihja as thërrimet e angazhimit të sajë jetësore, shoqërore, intelektuale e krijuese. Dhe, dorën në zemër, droja ishte e pranishme. Çka të shkruahej për njeriuan që asnjëherë nuk kishte rrahur gjoks se vetëm ajo kishte bërë diçka në kohën me të vështirë për Kosovën dhe popullin e saj të përvujtur e të përndjekur pameshirëshem nga

serbosllavia. Për njerin, e cila asnjëherë nuk e kishte ngritur kokën sipër njerëzve dhe sipër reve. Për një zonjë hiqej, as në ndihmën nga donatorë aneënd botës për Kosovën.

Dhe një ditë kur gjëndsha zyrtarisht në Tiranë, pas darke cingrima e telfonit më shpie dikund në një qytet të Zvicrrës. Ishte zeri i Behide Hasanajt e cila me fton që të martën me datën 10 shtator do të takoheshim në hotelin “Dukagjini” në Pejë. Atë ditë pas një qëndrimi miqësor marr në dorë shënimet dhe një mori okumentesh, shkresash, falenderimesh, me intervista të shumëllojshme për punën e gjatë gati tri dekadash në misione humanitare jo vetem në Kosovë, por në shumë shtete të Evropës e botës. Vërtet një kronikë facinuese për ngjarje, njerëz, periudha kohore, për punën e vrullshme në misione humanitare, për vizitat në kampe, fshatra e male të njerëzve të dëbuar nga vatrat e veta, për bisedat shumë të vështira me të burgosurit gjatë luftës, për bisedat rrëqethëse me të keqtrajtuarat e të përdhunuarat nga barbaria serbe. Pastaj për jeten familjare, për jetën e vendlindjes dhe për jetën shoqërore në përgjithësi. Këtu nuk janë etjshme shënime, nuk janë as ditarë, të gjitha ato bashkë me foto e dëshmi, mirnjohje e intervista janë një kronikë e mirëfilltë për periudha të ndryshme kohore në kohë të okupimit të Kosovës nga Serbia, për kohën e helmimeve të luftës, për ngjarje shumë të veçanta dhe për njerëz që kanë marr pjesë në ato ngjarje, e në veçanti për Trimat e lirisë, Ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kur lexon këtë material, shfleto gjithë ato intervista, biseda, vizita etj, që zë fill dikund në vitet tetëdhjeta, në kohën e helmimeve të nxënësve të shkollave në Kosovë e vjen deri në fund të viteve e vjen dikund në fundshekullin që lam pas, kur u zhvillua luftë në Kosovë, ngadal por pashmangshëm vetëdijeshëm se sa pak kemi bërë për të lënë shenja për jetën tonë, për bëmat tona nëpër periudha të ndryshme kohore.

Kjo monografi – kronikë e një jetë veprimtarie humanitare e Behide Hasanajt me këtë përmasë kohore, e bën shumë të qartë, i jep kuptim, e jetëson atë thënjën e mençur të dijes evropiane që thotë se prindi i tretë i njeriut është vendlindja. Kur kureshtinë e tij shpirtërore nuk e plotësonin përpjekjet për t’u ndihmuar njerëzve, angazhimi i përhershëm për të bërë diçka për Kosovën dhe njerëzit e sajë, pua e pakursyer për shtresat e varfëra e në nevojë...

Libri është i ndarë në kapituj, e në kuadër të tyre janë shtjelluar temat e caktuara që lidhen ngusht me kontributin humanitar të z.Behide Hasanaj. Janë paraqitur edhe dokumentet dhe fotografitë të veprimtarive humanitare të znj. Behide, të miqve e shokëve të saj e të bashkëpunëtorëve të shumtë kudo në shtetet evropiane e më gjërë që janë solidarizuar me popullatën e Kosovës dhe u janë dalur në ndihmë popullatës së Kosovës së përvuajtur në periudhat më të vështira, të luftës dhe të periudhës së vështirë që gjendjej populli i Kosovës edhe gjatë pasluftës. Andaj ky libër ka vlerë të patjetërsueshme dokumentare, sepse në të paraqitën dokumentet që janë krijuar me punën e znj. Behide, të bashkëpunëtorëve të saj të shumtë anë kënd botës, por, kryesisht të Shoqatë Humanitare “Nënë Tereza” që

ka vepruar në qytetin Thun të Zvicrës, por sidomos të bashkëpunëtorëve të saj që janë të shumtë që ia shtojnë edhe më shumë vlerën e librit. Libri kryesisht i përket zhanrit të librave monografiko – autobiografik, por më të drejtë mund të themi së më shumë ka karakter dokumentar, pasiqe kryesisht është i shkruar në bazë të dokumenteve që i ka në dispozicion zonja Behide dhe të cilat i ka rujtur me gjelozi dhe me një pedantri të jashtëzakonshme të cilat janë një argument i fortë dhe dëshmi për punën dhe aktivitetet që janë zhvilluar në kohë shumë të vështira për popullatën e përfutur në Kosovë, e pse jo edhe në vise të tjera të ish Jugosllavisë, por në të njejtën kohë edhe ia sh ia shtojnë vlerën e librit. Libri nuk ka karakter shkencoro-historik.

Prandaj kur marrim në dorë këtë material të një veprimtarie humanitare afro tri decenje dhe kujtojmë të vertetën se dokumentet përbëjnë bazën e identitetit të tyre dhe janë një element thelbësor i shoqërisë së informimit, lirisht mund të konstatojmë së ato ruajnë përjetësinë e kujtesës njerëzore, përkatësisht thesarin kulturor, trashëgiminë kulturore të një populli, të një treve, të një rajani, të një vendi. Çdo dokument i shkruar, fotografi ose dokument në zë, elektronik ose në media të tjera janë dëshmi e kohës kur janë krijuar. Gati të gjitha dokumentet janë krijuar me punën e znj. Behide, por shumica e tyre janë krijuar nga të tjerët, por të grumbulluar nga ajo dhe më pastaj shumica e tyre janë dorëzuar për ruajtje të përhershme në Arkivin Shtetëror të Kosovës, ku është krijuar si fond i veçantë me emrin e saj.

Nga shoqërimi im me te për një kohë jo më shumë së 5 – 6 orësh fitova përshtypjen se kjo zonjë për të cilën po shkruhet ky liber autobiografik dhe monografik, emodeste dhe e zakonshme në dukje ka një zemër he shpirt human. Për këtë tregon puna që ka bërë dhe po bën ajo. Sipas asaj që mësuam për pakë kohë kjo zonjë që quhet Behide Hasanaj një pjesë të pasurusë së saj personale e familjare ia dedikoj çështjeve humanitare njerëzve skamorë, sidomos femrave, por që ashtu si ajsbergu, të cilit i duket vetëm një pjesë fare e vogël e tij në krahasim me madhësinë e tij të vertetë, për të cilët sa herë të dëgjosh të flitet, një ndjenjë e ngrohtë të pushton shpirtin.

Në fund mund të themi se Behide Hasanaj, gjatë gjithë jetës së vet ishte dhe mbeti luftëtare i paepur për ndihmë popullatës skamnore të Kosovës, kjo është vërejtur në dokumentet që botohen në këtë libër për angazhimin e saj humanitar. Me kontributin humanitar ia ngriti veti një përmendore tani të shkruar, që populli i saj e sidomos ato familje dhe pesonalitete që ajo iu ndihmoi gjithmonë do ta kujtojnë dhe respektojnë përherë.

Dhe çka mund të themi fare në fund përveq asaj se kjo veperë, një punë gati tridhjetvjeçare e saj duhet të jetë një shëmbull dhe pse jo edhe një cytje, një

frymëzim edhe për diasporën tanë në shtetet tjera që të merr si shembull se si duhet punuar për atdheun dhe kombin, por edhe për të shkruar për kontributin e tyre për çështjen kombëtare, për atdheun dhe familjet e tyre.

Prishtinë, 26 Shkurt 2019

Nezir Prokshi, shkrimtar e publicist